

Ç'është liria absolute?

Sipas Camus, liria absolute është ajo liri, që nuk kushtëzohet nga shoqëria. Vetë Camus dyshon. Po i shpërfille të tjerët, mund të përfundosh në dhunë ndaj tyre dhe pas kësaj, nëse ke prekur kufirin e lirisë, ku është liria jote? Këtu duket sensi human i veprës.

Çfarë fitoi Mërsoi duke shpërfillur moralin e shoqërisë?

- 1- Sfidoi vdekjen
- 2- Nuk kërkoi mëshirë
- 3- As për ligji, as mohoi ato që bëri
- 4- Mbrojti të pacënuar lirinë e brendshme (absolute)

Arsyet e vërteta pse u dënua Mërsoi:

- Shpërfillja e normave të shoqërisë të kohës
- Nuk bënë përpjekje për ta fshehur me hipokrizi atë që bënë

-Autori nuk ka qëllim të tregojë sa keq është ndërtuar shoqëria, por sa të kota janë përpjekjet për ta ndryshuar atë.

Sfidat e veprës i drejtojen:

- 1- Absurditetin vdekjeprurës
- 2- Kaosit çmendurak
- 3- Parregullsi të botës
- 4- Ligjeve mizore të bazuara mbi dhunën dhe padrejtësinë

I huaj për Mërsoin:

Për shoqërinë, për veten, për kulturën arabe, për moralin kristian, për lexuesin, për drejtësinë, për emrin, për stilin e shkrimit.

Mesazhe:

- Absurdi luftohet me mjetet e absurdit.
- Absurdi prodhon revoltë.
- Prania e përsëritur e vdekjes, sipas ekzistencialistëve, e bënë shpërfillës njeriun.

-Vepër midis ekzistencializmit dhe absurdit

Afrimi me ekzistencializmin:

- 1- Rebelimi përmes veçimit/ Veçimi si formë kundërshtimi
- 2- Prirja për të ruajtur unin, thelbin/ për të mos u tjetërsuar
- 3- Përpjekja për t'iu larguar absurdit e afruar lirisë absolute

Romani “I huaji” sjell përmes Mërsoit **qenien ekzistenciale**:

- **Vetmia**- dënim për qenien njerëzore, reflektim ndaj shoqërisë, ecila prek liritë tona, e mbron njeriun nga absurdi. Ajo shfaqet në vepër me anë të tëhuajësimit/ veçimit.
- **Vdekja**, rituali i vdekjes shpërfillen. Duke shpërfillur vdekjen, rend pas jetës tokësore.
- **Liria**- sa kohë që mungon një forcë, që na drejton, ndjehemi të lirë. Por, sapo respekton lirinë tënde, ndërhyjnë shoqëria me gjykimin dhe ndëshkimin e vetë.
- **Mosveprimi/heshtja**- duket se Camus s’ka qëllim të tregojë çrregullimet e botës, por pakuptimësinë për ta ndrequr atë. Mërsoi nuk përfshihet në veprim, për të ruajtur të pandryshuar thelbin.

Veçori të stilit të Camus:

- 1- Vepra e Camus ka thelb filozofik.
- 2- Është me ligjërim të thjeshtë, pa figuracion, pa fjali të gjata. Kjo s’e varfëron, por e çon te gjenia, sipas studjuesve, për ta bërë sa më të afërt me njeriun.

3- Camus ndjek fatin e njeriut ndaj prekjes së lirisë.

4- Ka pak analiza shpirtërore, pak përshkrime natyrore, më shumë rrëfim.